

Formular për SYLLABUS të Lëndës: E DREJTA TRASHËGIMORE KRAHASUESE

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	E Drejta Trashëgimore Krahasuese
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	I(Semestri II)
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Bedri Bahtiri
Detajet kontaktuese:	bedri.bahtiri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<i>E Drejta Trashëgimore Krahasuese trajton marrëdhëniet e subjekteve në rastet e vdekjes përkatësisht marrëdhëniet mortis causa, duke u nisur nga legjislacioni aktual i Republikës së Kosovës.</i> <i>Kjo lëndë gjithashtu do ti trajton zhvillimet legjislative që janë në proces siç është përgatitja e Kodit Civil të Republikës së Kosovës që do të ketë një ndikim të madh në shoqërinë kosovare.</i> <i>Sistemi i ynë legjislativ do të krahasohet me sistemin legjislativ të kësaj fushë në shtetet Evropiane si dhe rregullimi ligjor i kësaj fushë në BE.</i> <i>Natyrisht se nuk mund të krahasohen të gjitha të drejtat e të gjitha vendeve, por do të trajtohen vetëm të drejtat, të cilat kanë pasur ose edhe kanë ndikim direkt ose edhe indirekt në të drejtën e Kosovës.</i> <i>Gjithashtu, nuk mund të krahasohen të gjitha institutet, por do të trajtohen ato qendrore dhe më të rëndësishme.</i>
Qëllimet e lëndës:	<i>Kjo lëndë mësimore ka për qëllim t’u ofroj studentëve njohurit themelore mbi rregullimin juridik të marrëdhënieve trashëgimore.</i> <i>Studentët do të fitojnë njohuri për këtë lëmi të së drejtës duke u bazuar në të drejtën pozitive në Republikën e Kosovës, përfshirë zhvillimet më të reja duke rrjedh nga</i>

	<i>projekti Kodi Civil dhe harmonizimi i ligjeve të veçanta.</i> <i>Kjo lëndë gjithashtu do tu ofron studentëve një vështrim krahasimor edhe me të drejtat tjera pozitive të Evropës dhe BE-së, në mënyrë që nëpërmjet krahasimit të të drejtave të tjera dëshirohet të arrihen njohuri të reja për të kuptuar më mirë dhe më drejtë të drejtën trashëgimore.</i> <i>Studentët me marrjen e njohurive nga kjo lëndë, do të jenë të përgatitur për çfarëdo pune juridike profesionale që mund ti trajtojnë si avokat, gjyqtarë apo ndonjë profesion tjetër juridik.</i> <i>Studentët do të zhvillojnë shkathtësi për qasje kritike për ligjin e Kosovës duke pasur njohuri edhe për drejtën pozitive e shteteve evropiane.</i> <i>Vend të veçantë do të zë edhe trajtimi i rasteve nga praktika gjyqësore vendore dhe ndërkombëtare, e me theks të veçantë praktika gjyqësore e Gjykatës për të Drejtat e Njeriu.</i>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<i>Zhvillimi i logjikës juridike</i> <i>Kuptimi i së Drejtës Trashëgimore në Kosovë dhe në shtetet tjera evropiane</i> <i>Të azhurnuar me zhvillimet më të reja në këtë fushë</i> <i>Zhvillimin e mënyrës së analizës dhe hulumtimit</i>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1/10	20
Ushtrime teorike/laboratorike	1	1/10	10
Punë praktike	1	1/10	10
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2/1	2
Ushtrime në teren	0	0	0
Kollokfiume,seminare	2	2/2	4
Detyra të shtëpisë	2	1/2	4
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	1	1/10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1/1	2

Projektet,prezentimet ,etj	8	1/1	8
Totali	ECTS 3	Total	90
Metodologjia e mësimëdhënies:	<i>Ligjërata interaktive, me ç’rast do të përfshihen edhe studentët në mënyrë që të zhvillohet logjika juridike, argumentimi dhe prezantimi.</i> <i>Përgatitja e punimeve seminarike dhe prezantimi i tyre si dhe mbrojtja e punimit seminarik gjatë debatit me kolegët e tyre.</i> <i>Pjesa praktike do të përfshinë shqyrtimi i rasteve në mënyrë analitike, të problemeve nga fusha e së drejtës trashëgimore, duke përfshirë edhe studimin e vendimeve gjyqësore. Shqyrtimi dhe zgjidhja e rasteve do të bazohet në të drejtën pozitive në Kosovë si dhe krahasimet me të drejtat tjera pozitive.</i> <i>Ushtrimet, janë pjesë e mësimit nga e drejta trashëgimore përmes të cilave studentët do të mësojnë më shumë rreth zbatimit praktik të së drejtës trashëgimore.</i>		
Metodat e vlerësimit:	<i>1. rregullsia dhe aktiviteti në ligjërata, vlerësohet prej 0-10 pikë;</i> <i>2. prezantimi i punimit seminarik, vlerësohet prej 0-10 pikë;</i> <i>3. kollokuimi vlerësohet prej 0-30 pikë;</i> <i>4. provimi përfundimtar vlerësohet prej 0-50 pikë.</i>		
Literatura			
Literatura bazë:	<i>Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2011</i> <i>Hamdi Podvorica, E Drejta Trashëgimore, Prishtinë, 2010</i> <i>Materiale tjera të ofruar nga Profesori</i>		
Literatura shtesë:	<i>Abdulla Aliu & Haxhi Gashi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2007</i> <i>Aleks Laurasi, Marrëdhëniet familjare, Laurasi, Tiranë, 2001</i> <i>INTERNATIONAL ENCYCLOPAEDIA FOR FAMILY AND</i>		

SUCCESSION LAW, Edited by : Walter Pintens Transnational and Comparative Family Law: Harmonization and Implementation By Marilyn Johnson Raisch Comparative Succession Law Marius J. De Waal The Oxford Handbook of Comparative Law Edited by Mathias Reimann and Reinhard Zimmermann Valentina Zaçe, Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar, Tiranë, 1999 Santhipi Begeja, E drejta familjare e Shqipërisë, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë Leslie J.Harris & Lee E, Teitelbaum, Family Law, Aspen Law & Business, New York, 2000 D. Kelly Weisberg & Susan Frelich Appleton, Modern Family Law- cases and materials, Law, Aspen Law & Business, New York, 1998. M.Alinčić- A.Abramović- D. Hrabar – J-Lozić – A, Korać, Obiteljsko Pravo, Narodne Novine, Zagreb, 2001. Dr. Juliana Latifi, E drejta e trashëgimisë në Kosovë, Prishtinë 2010 Nazmi Bicoku, E drejta e trashëgimisë e Republikës së Shqipërisë, Onrufi, 1999 Andria Gams, Hyrje në të drejtën civile, Pjesa për të drejtën e trashëgimit, Prishtinë 1986 Francesco Galgano, E drejta private, Luarasi, 2003	
Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimi gjatë semestrit dhe literaturën.
Java e dytë:	- nocioni dhe emërtimi i të drejtës trashëgimore

	- objekti i të drejtës trashëgimore - parimet themelore të së drejtës trashëgimore - burimet e të drejtës trashëgimore dhe metodat
Java e tretë:	- trashëgimi me ligj - koha dhe vend i çeljes (hapjes) së trashëgimit, trashëgimlënësi, trashëgimtari, - aftësia për të trashëguar - bazat e thirrjes në trashëgim - sistemet për caktimin e radhëve për thirrje në trashëgimi ligjore - radhët e trashëgimisë, e drejta e përfaqësimit dhe e drejta e shtimit
Java e katërt:	- trashëgimia e domosdoshme, padenjësia për trashëgim, - pranimi i trashëgimit - renconcimi (heqja dorë) nga trashëgimi - ndarja e trashëgimisë - transaksionet ndërmjet të gjallëve (inter vivos)
Java e pestë:	- trashëgimia testamentare - forma, kuptimi dhe përmbajtja e testamentit - zotësia për të bërë testament - pavlefshmëria e testamentit - legu - llojet e testamentit
Java e gjashtë:	- procedura e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore - kuptimi dhe parimet e procedurës së shqyrtimit të trashëgimisë - kompetenca e gjykatës në procedurën e shqyrtimit të pasurisë trashëgimore - përgatitja e seancës trashëgimore - seanca trashëgimore - aktvendimi për trashëgimi - mjetet e rregullta të goditjes së vendimit - mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimit
Java e shtatë:	- Ndryshimet sipas Kodit Civil
Java e tetë:	- Ndryshimet sipas Kodit Civil
Java e nëntë:	- Rregullimi i drejtës trashëgimore në shtetet rajonale
Java e dhjetë:	- Rregullimi i drejtës trashëgimore në shtetet rajonale
Java e njëmbëdhjetë:	- Rregullimi i drejtës trashëgimore në shtetet Evropiane
Java e dymbëdhjetë:	- Rregullimi i drejtës trashëgimore në shtetet Evropiane
Java e trembëdhjetë:	- Rregullimi i drejtës trashëgimore në shtetet Evropiane
Java e katërmëdhjetë:	- Rregullimi i drejtës trashëgimore në shtetet evropiane
Java e pesëmbëdhjetë:	Provim Përfundimtarë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konform Ligjit për arsimin e lartë, Statusit të UP-së dhe Kodit të mirësjelljes.</i>